



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

VENDIM

Nr.222, datë 25.04.2024

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATES {...} DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES
PARALELE NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË,
PËR POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS ADMINISTRATIVE, TË
SHPALLURA ME VENDIMET NR.256, NR.257 DHE NR.258 DATË 24.05.2023, TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 25.04.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat për lëvizjen paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 256, nr.257 dhe nr.258, datë 24.05.2023, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.256- nr.258, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e tre procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative.

2. Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 24.05.2023, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 14.06.2023.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionet e lira nr.256 deri nr. 258 datë 24.05.2023 kandidoi edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja) gjyqtare e Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier e transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe aktualisht e komanduar si Këshilltare ligjor, në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

4. Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 256/2023, 257/2023 dhe 258/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 346, datë 27.06.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim etik dhe profesional (shtojca nr. III) për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

4. Me Vendimin nr. 161, datë 03.04.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallur me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe 258 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim”, Këshilli ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallur me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe 258 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim.

II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ... 2. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro; ...”.

5. Më datë 03.04.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si vendimi 320/2020), në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

6. Brenda afatit të përcaktuar, kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidaten znj. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve.

8. Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me anë të postës elektronike të datë 04.04.2024, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

9. Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidates në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, informacioni u administrua në Këshillin e Lartë Gjyqësor, siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT

10. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”

11. “Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimeve nr. 256, nr. 257 dhe 258 datë 24.05.2023, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”*.

12. Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt në konsideratë se ajo ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe 258 datë 24.05.2023, çka do të thotë se kandidatja duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale në fushën e së drejtës administrative gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.

13. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 05.07.2002, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “Administrim Publik” pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2009 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Me vendim e datës 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për një përdhë nga tetor 2020 deri qershor 2021 nga ku komandohet në pozicionin “Drejtor i Departamenti të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë” në Këshillin e Lartë Gjyqësor për një periudhë 3 (tre) vjeçare. Më pas me një ndryshim të vendimit të datës 09.06.2021 Këshillit ajo ka kaluar “Këshilltar ligjor, në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme” në Këshillin e Lartë Gjyqësor, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Lidhur me fushën e veprimtarisë pranë dy njëjësive si e komanduar në Këshill sipas shprehjes së interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja konstatohet se: omissis...*“detyrat e mia funksionale kanë qenë ato që lidhen me hartimin e akteve administrative me natyrë individuale, kolektive dhe*

normative, në kuadër të veprimtarisë së përgjithshme legislative të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Përpos hartimit, për shumë prej akteve administrative të kundërshtuara nga subjektet e interesuara në gjykatat kompetente, jam autorizuar të përfaqësojë Këshillin e Lartë Gjyqësor për të bërë mbrojtjen e ligjshmërisë dhe vlefshmërisë së tyre. Sakaq, vlerësoj se eksperiencia ime si Gjyqtar i komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, përmbush plotësisht kriterin e eksperiencës profesionale në fushën e së drejtës administrative ”...omissis . Me tej vendim nr. 42, datë 31.01.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet për shkak të suprimimit të pozicionit, si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

14. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 05.07.2002, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “Administrim Publik” pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2009 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Me vendim nr. 478, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendim nr. 519, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Me vendim nr. 249, datë 09.06.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, komandohet në pozicionin “Drejtor i Departamenti të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë” në Këshillin e Lartë Gjyqësor për një periudhë 3 (tre) vjeçare. Me vendim nr. 253, datë 07.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, deklarohet ndryshimi i pikës 1, të vendimit nr. 249, datë 09.06.2021 të togfjalëshit “Drejtor i Departamenti të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë” me togfjalëshin “Këshilltar ligjor, në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme” në Këshillin e Lartë Gjyqësor, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Me vendim nr. 42, datë 31.01.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet për shkak të suprimimit të pozicionit, si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

15. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, të kandidatës konstatohet se ajo ka ushtruar funksionin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për një periudhë 8-mujore, (tetor 2020- qershor 2021) si edhe pjesa më e madhe e përvojës nga periudha 21.06.2021 e në vijim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor në pozicionin e jo magjistrates. Në këto rrethana Komisioni vlerëson se për të analizuar përvojën specifike të kandidatës duhet të analizojmë natyrën e aktivitetit të Institucionit Publik, KLGj, detyrat funksionale të kryera nga magjistratja në pozicionin e jo magjistrates, si edhe periudhën kohore të ushtrimit të kësaj detyre, e cila përfshin kohën e komandimit. Ky konkluzion bazohet në nenin 53, pika 9 të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se: “Përvoja e magjistratit të komanduar nga gjykata ose prokuroria e shkallës së parë në institucionin në të cilin magjistrati komandohet, llogaritet përvojë në profesion në shkallë të parë, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.”

15.1 Në vendimin e Këshillit nr. 320/2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, parashikohet se: “6. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ...dh) “Lëvizje paralele” nënkupton kalimin e gjyqtarit: ...ii) nga një pozicion i

komanduar në një pozicion në një gjykatë të të njëjtit nivel me atë të pozicionit që ka pasur përpara komandimit; f) “Përvojë në pozicionet e komanduara” nënkupton përvojën e veçantë të punës së kandidatit si gjyqtar i komanduar: në pozicionin e ndihmës magjistratit në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese ose në Prokurorinë e Përgjithshme; në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; në pozicione të tjera në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në Ministrinë e Drejtësisë, në Avokaturën e Shtetit, në Shkollën e Magjistraturës, në çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit sipas nenit 53, pikat 2 ose në një institucion tjetër të ndryshëm nga këto, kur komandimi është bërë për një interes publik sipas nenit 54, pika 7, të Ligjit për Statusin; g) “Përvojë profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë” nënkupton përvojën e veçantë të punës së kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë të shpallur;

16. Në këtë kuadër për verifikimin e kriterit të përvojës profesionale në fushën përkatëse të së drejtës të përshtatshme për pozicionin e lirë, relatori kërkoi dhe administroi informacion dhe dokumentacion nga institucioni ku ka qenë i komanduar. Nga informacioni i administruar marrë për kandidaten rezulton se ajo ka kryer detyrën e Drejtorit të **Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë si edhe këshilltar ligjor pranë Komisioneve të Përhershme angazhuar në hartimin e projekt akteve me natyrë normative, kolektive e individuale pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe përfaqësime në gjykatën administrative të shkallës së parë dhe të apelit etj.**¹

¹ Rregullore “Për shqyrtimin e praktikave korruptive në Këshillin e Lartë Gjyqësor”; Rregullore “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Këshillin e Lartë Gjyqësor”; Rregullore “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Këshillin e Lartë Gjyqësor”; Udhëzim “Mbi përcaktimin e procedurës dhe masës së kompensimit të gjyqtarëve/magjistratëve për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm ose për caktimin e përkohshëm”; Udhëzim “Për mënyrën dhe procedurën e kompensimit, për orët shtesë të kryera mbi kohën normale të punës, nga nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit e tjerë administrativë, në gjykatë”; etj. projektvendim “Për miratimin e listës së gjyqtarëve kandidat për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2022/2023”, projektvendimet për hapjen e pozicioneve të lira në Gjykatë të Lartë, Gjykatë apelit JP/administrative të apelit, Gjykatën e posaçme të shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; etj.; projektvendimin për fillimin e procedurave të verifikimit të kandidatëve; projektvendime për kualifikimin dhe praninë në shërbim civil të këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë; kualifikim, emërim, caktim në pozicion të magjistratëve etj.; mbrojtjen dhe hartimin e rekursve në çështjet me palë KLGJ, si Manjola Xhaxho kundër KLGJ; Dhimitër Lara kundër KLGJ; Altina Nasufi kundër KLGJ; Eranda Hysi etj. kundër KLGJ; Ardit Mustafa kundër KLGJ;

16.1 Neni 147 i Kushtetutës e përcakton Këshillin e Lartë Gjyqësor si organi publik i cili siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor. Si Institucion Publik Këshilli i Lartë Gjyqësor e shpreh vullnetin nëpërmjet akteve administrative individuale apo kolektive të cilat rregullohen për nga forma dhe procedura e nxjerrjes prej Kodit të Procedurave Administrative dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Veprimtaria administrative e këtij organi konkretizohet me hartimin dhe nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat janë shfaqje të vullnetit të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe kanë për qëllim, krijimin, ndryshimin, apo shuarjen e pasojave të caktuara juridike. Këto akte për nga forma apo përmbajtja e tyre janë akte administrative me karakter të mirëfillte individual, ose i drejtohen një numër të pacaktuar subjektsh (kolektive) pasi nxirren në zbatim të një norme të përgjithshme, rregullojnë një/disa çështje të caktuara, i drejtohen një numri të caktuar subjektsh, të cilët kanë kërkuar shprehjen e vullnetit të saj si dhe evidentojnë qartë karakterin shterues të tyre. Pikërisht në kuadër të ushtrimit të vullnetit të tij organi administrativ është i detyruar që të nxjerrë aktin administrativ i cili duhet të respektojë parimet kushtetuese. Parimet e shtetit të së drejtës të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, “E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit”-(neni 4 i Kushtetutës). Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë, në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie. (neni 13 i Ligjit nr.44/2015, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”). Me një natyrë të aktivitetit të pastër administrativ duke shprehur vullnetin nëpërmjet “*acte administrative*”, Këshilli ka qenë i detyruar të integrojë nëpërmjet Institutit të Komandimit edhe gjyqtarë në burimet e veta njerëzore me qëllim disponimin dhe shkëmbimin e ekspertizës më të mirë ligjore edhe në këtë fushë, konform nenit 53 të Ligjit për Statusin. Në këtë rast magjistrati i komanduar ushtron funksionet e një teknikieni të mirëfilltë, duke ruajtur kështu profilin e saj profesional nga njëra anë dhe nga ana tjetër respekton pajtueshmërinë e funksionit me pavarësinë dhe statusin e posaçëm të magjistratit.

16.1.1 Kjo dispozite e përkufizon komandimin e magjistratit si lëvizjen e tij në një pozicion të jo magjistrati në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, pozicion i cili është i pajtueshëm me pavarësinë dhe mbajtjen e statusit të tij. Pikërisht lëvizja e përkohshme e magjistratit në një vend pune të një funksionari shtetëror jo magjistrat realizohet nëpërmjet institutit ligjor dhe procedurës së komandimit. Në kuadër të këtij Institucioni një rëndësi staturore dispozita ligjore i ka dhënë edhe përvojës profesionale si një nga komponentët më të rëndësishëm vlerësues. Në lidhje me përvojën, fjalori i gjuhës shqipe, botim i vitit 1985, e konsideron si tërësia e njohurive, e shprehive etj., që fitohet në jetë e në punë.

16.1.2 Ndërkohë Ligji për Statusin (neni 53/9) ka parashikuar se, për efekte të zhvillimit të karrierës, magjistratit të komanduar nga gjykata në institucionin në të cilin magjistrati komandohet, periudha e komandimit i llogaritet si përvojë në profesion në shkallë të parë apo përvoja e magjistratit të komanduar, nga gjykata në shkallë të dytë, në institucionin në të cilin magjistrati komandohet llogaritet si përvojë në profesion në shkallë të dytë.

16.2. Më tej në përvoja konsiderohet shumë e rëndësishme edhe kur ndihmës magjistrati ushtron funksione drejtimi pasi ushtrimi i funksioneve drejtuese në institucionin në të cilin magjistrati komandohet vlerësohet si përvojë drejtuese edhe në gjykatën ku ai konkurron.

16.2.1 Në të njëjtën logjikë favorizuese ligjore legjislatori ka hartuar edhe rregullimet në nenin 47 dhe 48 të këtij ligji. Kështu, në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 47 parashikohet se, për efekt të ngritjes në detyrë nga magjistrat në gjykatën e posaçme të shkallës së parë në gjykatën e posaçme të apelit, në periudhën shtatë vjeçare përllogaritet edhe periudha që magjistrati ka punuar i komanduar. Respektivisht pika 4, 5 dhe 6 e nenit 47 të ligjit parashikon se vjetërsia në punë si magjistrat i komanduar përllogaritet si vjetërsi edhe për efekt të ngritjes në detyrë, qoftë në gjykatën në shkallë të dytë, për në Gjykatën e Lartë apo edhe për t’u emëruar si kryetar gjykate.

16.2.2 Në të njëjtën mënyrë neni 43 në pikën 7/a/i ka parashikuar se renditja e magjistratëve në lëvizjen paralele bëhet ndër të tjera duke marrë parasysh dy vlerësimet e fundit të magjistratit të komanduar dhe se në të njëjtën kohë periudha e angazhimit të magjistratëve në pozicionet e komanduara do të konsiderohet si vlerë e shtuar. Pika 3 e nenit 265 të Ligjit Nr. 115/2016 “Për organizimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim Ligji për organet e drejtësisë) parashikon se magjistratëve të komanduar si pedagogë të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës i u njihet si **periudhë vjetërsie në punë, si gjyqtarë apo prokurorë, për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat ligjore.**

16.3 Për më tepër neni 48 i ligjit parashikon se **përvoja e magjistratëve** në pozicionet e komanduara do vlerësohet ligjërisht në optikën e organeve përgjegjëse me përparësi në ngritjen në detyrë të tyre në krahasim me kandidatët e tjerë. Ky avantazh theksohet për të dytën herë nga ligji edhe në pikën 3 nenin 57 të këtij ligji, ku parashikohet se: “3. Vetëm në ato raste kur magjistrati ka kryer të gjithë periudhën e komandimit, Këshilli e konsideron me përparësi në lëvizjen paralele ose në procedurat e ngritjes në detyrë”.

16.3.1 Qëllimin e respektimit të vlerësimit të këtij komponenti, përvojën e komandimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor e ka integruar edhe në aktet e vetë normative. Kështu p.sh. Vendimi i KLGj-së nr. 70, datë 7.2.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, pika 7, germa “f” shprehet se “Përvojë në pozicionet e komanduara”, nënkupton përvojën e veçantë të punës së gjyqtarit si gjyqtar i komanduar: në pozicionin e ndihmës magjistratit në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese; në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; në pozicione të tjera në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në Ministrinë e Drejtësisë, në Avokaturën e Shtetit, në Shkollën e Magjistraturës ose në çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit, sipas pikës 2, të nenit 53,3 të ligjit për statusin; në çdo pozicion tjetër të ndryshëm nga këto, kur komandimi është bërë për interes publik, sipas pikës 7, të nenit 54, të ligjit për statusin; si dhe në çdo pozicion ku është komanduar me vendim të institucioneve të tjera, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi përpara ligjit për statusin, në rastin kur gjyqtari ka kryer të gjithë periudhën e komandimit.

16.3.2 Mbajtur në vëmendje sa më lart, në përputhje me pikën 9 të Nenit 53 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pikën 55 të vendimit 320/2020 të KLGj -së, arrihet në përfundimin se **përvoja apo eksperiencia** në fushën përkatëse do të vlerësohet nga burimi i marrëdhënies së punës të krijuar midis tij dhe Institucionit ku është komanduar. **Natyrisht që përvoja në kuptim të ligjit do të rezultojë nga natyra e punës dhe kontributit të magjistratit në Institucionin e komanduar e cila duhet të jetë e vazhduar dhe**

jo sporadike në përputhje me afatin e plotë të caktuar për tu komanduar në të. Analiza e aktivitetit të Institucionit të mundëson në identifikimin e fushës ku magjistrati ka kontribuar dhe si rrjedhim dhe përvojën përkatëse minimale, (neni 47/4 – përvojë 5 në 7 ose neni 43/ 6 i Ligjit Për Statusin, përvojë 1 në 5), të përfituar për shkak të këtij aktiviteti.

Interpretimi i ndryshëm i këtyre parashikimeve ligjore do të bënte të pamundur përlllogaritjen e eksperiencës së magjistratit të komanduar në Këshilla, Ministrinë e Drejtësisë, Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut etj. institucione të tilla që nuk lidhen ngushtë me një lëndë të caktuar të së drejtës, por përfshijnë disa degëzime të saj.

16.4 Për me tepër eksperiencia e magjistratit të komanduar, pavarësisht se ku është ushtruar detyra është konsideruar **si eksperiencë e posaçme** për secilin pozicion të lirë të përhershëm që ka kërkuar si kriter procedura e lëvizjes paralele apo ngritja në detyrë duke u formalizuar me vendimmarrjet përkatëse të cilat aktualisht për shkak të pasojave të krijuara kanë formësuar edhe sigurinë juridike në këtë drejtim². Parimi i sigurisë juridike mbron garancitë që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës, ku përfshihet edhe e drejta e karrierës, si pjesë përbërëse e statusit të gjyqtarit dhe një nga përfitimet e tjera që gjyqtarët gëzojnë për shkak të funksionit. Qëllimi i parimit të sigurisë juridike është të sigurojë besimin e personave të shteti e ligji dhe vetë gjyqtarët, të cilët administrojnë drejtësinë, duhet të gëzojnë një besim të tillë (shih vendimin nr.11, datë 06.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

16.5 Duke i kthyer analizës së vendimmarrjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku në shumë projekte të tyre janë pasqyrim i kontributit të kandidatës, të tilla si **projekt- vendimesh për zhvillim karriere gjyqtaresh, projekt rregullore, projekt udhëzime të cilat rregullohen në mënyrë të posaçme nga Kodi i Procedurave Administrative**, ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligji 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ligji 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe janë akte administrative apo legjislacione të tjera rezultojnë se përvoja e përfituar në këtë fushë do të duhet të konsiderohet si administrative.

16.5.1 Kohë zgjatja e komandimit të kandidatës për më shumë se 2.5 vjet pranë Këshillit në një fushë tipike administrative përfshin jo vetëm afatin kohor të përcaktuar në nenin 43 pika 6 të Ligjit Për Statusin, por edhe parashikimet e përvojës minimaliste dhe kriteret e emërimit të magjistratëve të sapo diplomuar dhe integritet të tyre në Gjykatën e Juridiksionit të veçantë, atë Administrative. **Pika 5, e nenit 39, të Ligjit nr. 96/2016** “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se *“I emëruari që caktohet në pozicion në gjykatat administrative, duhet të ketë përvojë pune në të paktën një vit e gjysmë në administratën publike ose të ketë rezultate "shumë të mira" në lëndët e së drejtës administrative në Shkollën e Magjistraturës”*. Në fakt z,{...} si magjistrate e komanduar në Këshillin Lartë Gjyqësor ka përvojë pune, në këtë Institucion, dy vjet deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për procedurën në lëvizjes paralele.

² Vendim nr. 521 datë 05.10.2023 (verifikim kriteret formale për lëvizje paralele të znj. Ina Hoxhaj); Vendim nr. 355 datë 09.09.2021 (verifikim kriteret formale si dhe figure pasuri për ngritje në detyrë në GJPAKKO të z. Florjan Kalaja); Vendim nr. 162 datë 14.04.2021 (verifikim kriteret formale për ngritje në detyrë në GJPAKKO të z. Engert Pëllumbi).

17. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 256, nr. 257 dhe 258 datë 24.05.2023, ka mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës administrative dhe si gjyqtare e komanduar gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

18. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

19. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të vendimeve nr. 256, nr. 257 dhe 258 datë 24.05.2023, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë ... nëse ka në fuqi një masë disiplinore.”*

20. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 14.06.2023, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

21. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

22. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

23. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

24. “Papajtueshmëria ambientale” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të vendimeve nr. 256, nr. 257 dhe 258 datë 24.05.2023, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... transferimit, ..., për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproportionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”.* Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”.* Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me lëvizjen paralele, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse*

respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.

25. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 14.06.2023, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

26. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për lëvizjen paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

27. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidaten Këshilli vlerëson se znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUZIONE

28. Referuar kërkesave të Vendimit 320/2020, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimeve të Këshillit nr. 256, nr. 257 dhe 258 datë 24.05.2023, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të znj. {...} për lëvizjen paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

29. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kritere. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe 258 datë 24.05.2023.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 8 dhe në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin e tij nr. 320, datë

17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, si dhe në pikën 10, të vendimit të tij nr. 256, datë 24.05.2023, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”; vendimit të tij nr. 257, datë 24.05.2023, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”; vendimit të tij nr. 258, datë 24.05.2023, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”,

V E N D O S I:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 256, nr.257 dhe nr.258, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR